



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2618 prot.

Shkodër, më 07.09.2021

V E N D I M

Nr. 274, datë 07.09.2021

"Për miratimin e shtesës në rregjistrin e parashikimeve publike për vitin 2021"

Në mbështetje të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar), të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa h, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.20210 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar), të Ligjit nr.137/2020, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", VKM nr.75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", Udhëzimit të përbashkët nr.20, datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelimit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 të MASR dhe MFE "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim propozimin e Administratores së Universitetit, në mbledhjen e tij të datës 07.09.2021

Vendosi:

1. Miratimin e shtesës prej 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për shërbim interneti në rregjistrin e parashikimeve publike për vitin 2021.
2. I përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Prof. dr. Suzana COLEMI